**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

**Shtojca 4/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË PUNIMEVE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**V ula**

**Shtojca 6**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> <b>Punë:</b> Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_



**Shtojca 8**

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

**FORMULAR VLERESIMI**

**( Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)**

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
<b>VERTETOJ SE</b>	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/	
Bashkimi i operatorëve NIPDET/	
Nënkontraktorët NIPDET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktorët	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik:\_\_\_\_\_

**Deklaroj se zoteron mjetet pajisjet teknike dhe asete te tjera fizike per te realizuar kontraten me objekt:\_\_\_\_\_**

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi**

## Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

### DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>3</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

<sup>3</sup> Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Sipas Shtojcës Nr.11, pika 1, "Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit"

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 45, të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.**

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) te te pakten te njerit te 3 (tre) viteve te fundit (2017, 2018, 2019) të çertifikuar nga organet tatimore, shoqëruar me raportin e Ekspertit Kontabël të Miratuar, ne rast se përmbush kushtet e parashikuara në Ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit.26, Pika 7/a të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 29, pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe neni 41, gërma "c", e Ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.**

2.2.2 Xhiroja vjetore mesatare e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2017, 2018, 2019) të jetë sa vlera e fondit limit dhe për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike.

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit.26, Pika 7/b të VKM Nr. 914, datë**

**29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 65, pika 6 e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar.**

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues të mos ketë detyrime për taksat vendore per vitin e fundit, për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Ekstraktit Historik të Rregjistrimit Tregtar, për të cilat duhet të paraqesi një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta paraqesi secili prej anëtareve të bashkimit të shoqërive.

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.**

### **2.3. Kapaciteti teknik:**

I **2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi,

#### **Ose**

Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të marra së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit që do prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipër përmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

● Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) Kontraten/at,
- b) Situacion përfundimtar,
- c) Aktin e kolaudimit
- d) Formular Vlerësimi/Realizimi nga autoriteti kontraktor.

● Për kontrata te realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) Kontraten/at,
- b) Situacion përfundimtar
- c) Aktin e kolaudimit
- d) Faturat tatimore,
- e) Formular Vlerësimi/Realizimi.

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenin.26, Pika 6, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.**

**2.3.2** Liçenca Profesionale e operatorit ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPTT/MTI, e vlefshme në kategoritë e mëposhtme:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

NP- 2 A Ndertime civile dhe industriale

NP- 3 A Rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasadash

NP- 11 A Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise

NS -1 A Punime per prishjen e ndërtimeve

NS- 2 A Impjante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

NS – 4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri,plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.

NS – 12 A Impjante teknologjik, termike dhe te kondicionimit.

NS -14 A Impjante të brendshme elektrike, telefonie, radiotelefoni TV

Stafi Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje :

- 1) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi; (vërtetuar me diplomë).
- 2) 1 (një) Inxhinier Elektrik; (vërtetuar me diplomë).
- 3) 1 (një) Inxhinier Mekanik; (vërtetuar me diplomë).
- 4) 1 (një) Inxhinier Mjedisi; (vërtetuar me diplomë).

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në Liçencën e Shoqërisë dhe Listëpagesat për periudhën Janar 2020 – Janar 2021.

*Plotesimi i kesaj kerkese shërben për të provuar kapacitetin teknik dhe profesional të ofertuesit dhe për të gjykuar nëse ofertuesi është në gjendje të realizojë kontratën që prokurohet.*

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46 te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit.26, Pika 8/a të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, VKM nr.42, datë 16.01.2008 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI", i ndryshuar.**

Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, te figuroje ne listëpagesat per periudhen Janar 2020 – Janar 2021 dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) Listëpagesat për periudhën Janar 2020 – Janar 2021

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit. 26, Pika 5, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Ligji Nr. 8402, date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar.**

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesi një vërtetim nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 20 punonjës për periudhën Janar 2020 – Janar 2021 shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar 2020 – Janar 2021. *Plotesimi i kesaj kerkese shërben për të provuar kapacitetin teknik dhe profesional të ofertuesit dhe për të gjykuar nëse ofertuesi është në gjendje të realizojë kontratën që prokurohet.*

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46 te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit. 26, Pika 8/b, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.**

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht për muajin e fundit, si staf teknik punonjës, të pajisur me çertifikata të sigurimit teknik ose çertifikata ekuivalente të cilat të jenë të lëshuara nga ente çertifikuese të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe të figurojnë në listëpagesa, si më poshtë vijon;

- 2 (dy) Punonjës bojaxhi
- 1 (nje) teknik ndertimi
- 1 (nje) punonjës hidroizolues
- 2 (dy) punonjës elektrikist

Për punonjesit teknik si më sipër, të paraqitet Kontrata e punës e vlefshme, çertifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

*Plotesimi i kesaj kerkese shërben për të provuar kapacitetin teknik dhe profesional të ofertuesit dhe për të gjykuar nëse ofertuesi është në gjendje të realizojë kontratën që prokurohet.*

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 46 te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit. 26, Pika 8/b, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.**

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, si më poshtë vijon;

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësise) ose ekuivalente.
- b) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalente.
- c) OHSAS 18001- 2007 ose ISO 48001:2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) ose ekuivalente.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkepunimit.

**Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e neneve. 23 e 46, të Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit. 26 Pika 8/a, të VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.**

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike si më poshtë vijon;

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamionçine (minimumi kapaciteti total mbajtës deri në 1.5 ton)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
2	Skela (minimumi)	50	m <sup>2</sup>	Në pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 10 (dhjete ) copë
- Jelekë minimumi 10 (dhjete ) copë
- Fikse zjarri të lëvizshme minimumi 1 (nje) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë
- a) Makineritë dhe pajisjet në pronësi të shoqërohen me dokumentacion vërtetues për disponimin e tij (akt zhdoganimi dhe/ose faturë blerje dhe/ose çdo dokumentacion ligjor që e vërteton).
- b) Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik me emër objekti, si dhe të shoqërohen me aktin e vërtetimit të pronësisë të qiradhënësit.
- c) Kontrata e qirasë për makineritë në fjalë duhet të jetë e shtrirë në një kohë brenda afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- d) Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
- e) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese.

**II Shënim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e neneve. 23 e 46, të Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit. 26 Pika 8/c, të VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".**

**Te tjera,**

**Subjekti ekonomik per nenskrimin e kontrates ne perfundim te procedures duhet te kete edhe:**

- 1- Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin, per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave.
- 2- Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje te vlefshme te kontrates se lidhur me Shoqerine e Certifikuar per zgjidhjen software-ike ne perdorim, per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes software-ike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE** **SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME**

#### 1.1 Specifikime të përgjithshme

##### 1.1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “ . ”

##### 1.1.2 Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

##### 1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

##### 1.1.4 Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

#### 1.2 Dorëzimet te Supervizori

### 1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimit, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

### 1.2.2 Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

#### Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

### **Punime dheu**

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresa) dhe gërmimet për struktura në kanale. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin sipas prerjeve terthore, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, dhe rifiniturat e shtatit të prerjes. Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që do të gërmohen me makineri.

Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më të madhe të gërmuar nën nivelin e formacionit, brenda tolerances së lejuar, duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Të gjitha zonat horizontale të gërmuara, duhet të ngjeshen me një minimum dendësie të thatë prej 95% për dhera të shkrifët dhe 90% për dhera të lidhur.

Sheshi ku do të gërmohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, rrënjët e mëdha, plehrat dhe materiale të tjera sipërfaqësore. Të gjithë këto materiale do të spostohen dhe largohen në mënyrë që të jetë e pëlqyeshme për Punëdhënësin. Të gjitha pemët dhe shkurret që janë përcaktuar nga Punëdhënësi që do të ngelen, do të mbrohen dhe ruhen në mënyrën e aprovuar.

### 1. Gërmim dheu themel

Gërmim dheu themele ose për punime nentokesore, deri në thellesinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thate ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në pergjithësi etj., Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit të themeleve me materialin e Gërmimit të kryer me krah, si dhe spostimin brenda ambientit të kantierit.

### 2. Transport auto deri 5 km (Mbeturina + Dhera)

Transport i materialeve inerte që do të depozitohen në vendin e perkohshëm të depozitimit do të evadohen çdo ditë në fund të ditës me automjet për tu hedhur në vendin e përcaktuar nga bashkia e qytetit.

### 3. Transport me krahë 50 ml (Mbeturina + Dhera)

Transport i materialeve inerte dhe mbeturinave do të bëhet me karroca dore deri në venddepozitim dhe tyre brenda kantierit.

## **Punime Muratori**

### 1. Mur guri themel e xokul Ll.B. M.15

Ky ze përfshin teresinë e punimeve që lidhen me ndertimin e murit, blerjen e materialeve, ngarkimin transportin deri në vendin e caktuar ku do të bëhet muri.

Guret duhet të jenë të pastruar mirë nga material argjili. Për llacin perdoret grani I thyer 100% ore rere lavatriceje. Raportet e përgatitjes janë 35% gure 38% llac 27% granil ose rere e thate. Gjate përgatitjes duhet të merren kampjone betoni të llacit të përgatitur me dimensione 10x10 dhe 15x15 të cilat prodhohen për qëndrueshmëri në shtypje në laboratorët të akredituara nga organet shtetërore.

### 2. Brez B/A M.150 15cm mbi themel

Përfshin realizimin e një brezi të sipërme me beton/arme M150, 15cm mbi themel, i armuar në mënyrë të rregullt me muraturen e sipërme, duke përfshirë kallepet, Përforcimin, hekurin dhe betonin me dozim në m<sup>3</sup>: çimento 400 kg 260, rërë e lare m<sup>3</sup> 0,44, granil m<sup>3</sup> 0,70, uje industrial

## Dokumenta Standarde të Tenderit

m<sup>3</sup> 0.19, si dhe çdo gje tjetër të nevojshme për të dhënë fund muraturës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte.

### 3. Mur tulle i plotë 25 cm LL.B. M.15

Muraturë me tulla me 6 vrima, me trashësi 25 cm dhe llaç bastard m-15, me dozim për m<sup>3</sup>: tulla me 6 vrima nr.205, llaç m<sup>3</sup> 0.29, çimento 400 kg 44 dhe ujë, përfshirë çdo mjeshtri për dhëmbët e lidhjes, qoshjet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër për t'i dhënë fund muraturës dhe për ta realizuar në mënyrë perfekte.

### 4. Mur tulle i plotë 12 cm LL.B. M.15.

Muraturë me tulla me 6 vrima, me trashësi 12 cm dhe llaç bastard m-15, me dozim për m<sup>3</sup>: tulla me 6 vrima nr.205, llaç m<sup>3</sup> 0.29, çimento 400 kg 44 dhe ujë, përfshirë çdo mjeshtri për dhëmbët e lidhjes, qoshjet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër për t'i dhënë fund muraturës dhe për ta realizuar në mënyrë perfekte.

### 5. Zënie dritare egzistuese me mur guri

Zënie e dritareve ekzistuese me mur guri të lidhur me llaç M-25.

## **Punime Betoni dhe B/Arme**

### 1. Arkitratë B/Arme M.200 Parafabrikat

Arkitrar betoni të armuar, të realizuar dhe të armuar në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, të formuar me beton nga inertet e imta për kategoritë e betonit B (respektivisht M200) konform STASH 512-78, do të jenë prej rëre natyrale, gurë të shoshitur, ose materiale të tjera inerte me të njëjtat karakteristika apo kombinim të tyre të hedhur në vepër në shtresa të holla dhe të vibruara mire, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallepet, Përforcimin, hekurin e armatures si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

### 2. Trarë B/Arme M.200 Monolit

Trar betoni të armuar, të realizuar dhe të armuar në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, të formuar me beton nga inertet e imta për kategoritë e betonit B (respektivisht M200) konform STASH 512-78, do të jenë prej rëre natyrale, gurë të shoshitur, ose materiale të tjera inerte me të njëjtat karakteristika apo kombinim të tyre të hedhur në vepër në shtresa të holla dhe të vibruara mire, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallepet, Përforcimin, hekurin e armatures si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

### 3. Soletë B/Arme M.200 Monolit 15 cm

Soletë beton arme, të realizuar dhe të armuar në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, të formuar me beton m-200 të hedhur në vepër në shtresa të holla dhe të vibruara mire, me dozim sipas STASH 512-78, duke përfshirë hekurin, kallepet, puntelimet, perforcimet, skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

4. Termoizolim solete me polisterol

Termoizolimi realizohet duke përdorur materiale termoizoluese polisterol të vendosura në formë të pjerrët në zonat e shtresave hidroizoluese. Mbulimi me shtresa llaçi i pjerrësisë së kërkuar me një minimim trashësie prej 3 cm, e realizuar me llaç çimento (tipi 1:2), e niveluar për instalimin e shtresës izoluese.

**Punime Shtresash**

1. Shtresë betoni M.100 (Shtresa)

Ky ze perfshin shtrimin, vibrimin dhe nivelimin me helikopter te dyshemese me shtrese betoni M.100.

2. Shtresë zhavorri 10 cm

Ky ze perfshin teresine e te gjithë punimeve, qe lidhen me mbushjen me cakell te dyshemese perpara se te hidhet shtresa e betonit M.100. Te kihet kujdes ne ngjeshjen e cakellit, deri ne densitet 98%. Cakelli duhet te jete nga thyerje e gurit te kaves me granulometri jo me shume se 5/40.

3. Izolim dysheme me bitum

Shtresa e betoni te dyshemese pasi te thahet do te izolohe me bitum, me dy duar.

4. Shtresë dysheme me pllaka porcelanat C.I të bardha importi

Shtresa e betoni te dyshemese pasi te izolohe do te vishet me pllaka gres-porcelan te bardha te importit, duke i ngjitur me kolle dhe fugat do te mbudhen me bojak.

5. Trotuar komplet gjerësi 15 ml (i ri)

Gërmim në një thellësi 15 cm nga niveli i tokës; vendosja e bordurave të parafabrikuara me beton M 200 me dimensione 25x12 cm me gjatësi të ndryshme sipas skicave përkatëse dhe me bazament të futur 15 cm në tokë; 15 cm është shtresë zhavor lumi pa mbeturina; 6 cm shtresë betoni M 100.1 me fugaturat në çdo 3 m të mbushura me zift dhe rërë niveluar dhe me pjerrësi sipas vizatimeve përkatëse e formuar me shtresa të vibruara mirë; pllakat e çimentos të vendosura me llaç gëlqere me dozaturën përkatëse për m<sup>2</sup>: 1.02 m<sup>3</sup> llaç gëlqere (tipi 15) 4 kg çimento ( tipi 400). ujë, ngjitës, pastrimi dhe plotësimi i gjithë kërkesave për një punë me cilësi të mirë.

**Punime Suvatimi**

1. Suva murr tulle i brendshëm LL.B. M.15

Sprucim i mureve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve te muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per

## Dokumenta Standarde të Tenderit

ti dhene plotesisht fund sprucimit. Suvatim i realizuar nga nje Shtresë me trashesi 2 cm Llaçi bastard m-15 me dozim per m<sup>2</sup> : rërë e lare m<sup>3</sup> 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m<sup>3</sup> 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

### 2. Fino mbi murret e brendshëm godina egzistuese

Patinaturë muri realizohet me fino të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të suvuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m<sup>2</sup>. Lartësia e patinaturave për ambientin do të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë

### 3. Veshje me pllaka majolike në WC H = 2.5

Veshja e mureve te tualetit me pllaka majolike deri ne lartesine 2.5 metra.

### 4. Suvatim i jashtëm Granil + Çimento e bardhë

Sprucim i mureve per murature, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e siperfaqeve te muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit. Suvatim i realizuar nga nje Shtresë me trashesi 2 cm llac te bere me granil dhe cimento te bardhe, e aplikuar, ne baze te udhezimeve te pergatitura, ne mure , dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte

## **Punime Dyer – Dritare**

### 1. F.V Dritare D/Plast + D/Xham

Furnizimi dhe vendosja e dritareve sic pershkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbehen nga material PVC profilet e të cilit jane sipas standarteve Europiane ISO EN 9002. Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës Se investitont. Dritaret rreshqitese të PVC duhet të sigurojnë izolim meanë të një gome dhe adaptues në lidhje me komizën. Seleksionimi I hapësirave të ndryshme lejon perdorim xhami tek ose dopio. Boshllëku brenda xhamit dopio duhet të jetë 20- 24mm. Sistemet e dritareve PVC duhet të sigurojnë në mënyrë perlekte izolimin nga ajn dhe uji. Ato duhet të sigurojnë një rezistence nga uji nën 500Pa (të barazvlefshme me shpejtësinë e erës prej 150km/ore). Testet per këtë duhet të jenë në përputhje me DIN 18055. Koeficienti I konduktivitetit termal duhet të jetë 2.0W (m2K) e cila konfirmon Standartet Europiane. Ne lidhje me izolimin e zërit, dritaret prej PVC duhet të sigurojnë izolim ndaj tingujve den në shkallën 4 (>40dB). Komiza fikse e dritares (ndarjet) do të ketë një dimension 74-116mm. Ato jane të sigoruar me elemente, që sherbejne per vendosjen dhe ankonmin në strukturat e murit si dhe pjesët e dala që shërbejne per rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qellim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili I skeletit të dritares do te jetë me përmasën 25 mm e ala do te mbulohe nga profili kryesor qe do të fiksohet ne mur. Te dyja komiza fikse ose të lëvizshme jane projektuar dhe jane ndërtoar me fugë ajn që shërben si thyerje termike. Ato duhet te ofrojnë zbatim të Standarteve Europiane të



## Dokumenta Standarde të Tenderit

vendosjes Se xhamit (Xham tek 4-6mm, xham dopio 20-24mm, xham tresh 24-28 mm), me kullues uji me mbledhës uji, me inklinim 2 grade per të siguruar kullim uji perfekt, mbyllje perfekte nga mbyllesit qëndror, trashësi muri qe arrin EN (t-3.1 mm), izolim per erën dhe shiun ulluk unik I projektuar per të ndihmuar instalimin e materialeve te gomuar, që sherbejnë per këtë qëllim. Karakteristikat e ngjitesit kundër agjentëve atmosferike duhet të jenë të provuar nga një testim i çertifikuar I bere, nga prodhuesit e komizes së dritares ose nga prodhuesit e profileve.

### 2. F.V Dyer të brendëshme druri

Siguroni dyer druri të tipeve, madhësive dhe të skicave të treguara në figurat. Dyert e drurit te zyrave te cilat jane standarte do te jene prodhim importi i gatshem, me kompesate lisi ne ngjyre natyrale. Fashaturat e dyerve te jene me gjeresi jo me pak se 10cm dhe te jene prej druri natyral, (jo EDF). Brava te jete me bukature dy pjeseshe. Llustra natyrale: Siguroni dyer të ilustruara në fabrikë nga prodhuesi i dyerve si më poshtë: Veshja duhet të jetë AWI QS gjysëm e shkëlqyer, efekt i vijëzimeve të drurit të afërta. Ngjiti cepat, prerjet, ornamentet dhe aksesoret e drurit dhe aplikoni dy veshje me llustër, kompatibël me llustrën e faqes së derës. Jepini dorën e fundit llustrëve që mund të jenë gërvishur ose prishur ose kur vrimat e vidave janë mbushur, sipas instruksioneve të prodhuesit të dyerve. Përputhni ngjyrën dhe shkëlqimin e llustrës me atë të fabrikës duke përdorur materiale kompatibël për përdorim në vend. Llustra e shtresave plastike: E aplikuar që në fabrikë, e tipit të përgjithshëm ose për qëllim specifik, me trashësi minimale 1.25 mm. Ngjitni me tutkall shtresën plastike për dyert tambura, tek rimesoja e drurit, kompensata ose tek mbështetsja e pasme, për të formuar panelin e derës. Trashësia minimale e shtresës plastike dhe mbështetses sëbashku duhet të jetë 2.5 mm.

### 3. F.V Derë e jashtme druri (Hyrja)

Siguroni dyer druri të tipeve, madhësive dhe të skicave të treguara në figurat. Dyert e drurit te zyrave te cilat jane standarte do te jene prodhim importi i gatshem, me kompesate lisi ne ngjyre natyrale. Fashaturat e dyerve te jene me gjeresi jo me pak se 10cm dhe te jene prej druri natyral, (jo EDF). Brava te jete me bukature dy pjeseshe. Llustra natyrale: Siguroni dyer të ilustruara në fabrikë nga prodhuesi i dyerve si më poshtë: Veshja duhet të jetë AWI QS gjysëm e shkëlqyer, efekt i vijëzimeve të drurit të afërta. Ngjiti cepat, prerjet, ornamentet dhe aksesoret e drurit dhe aplikoni dy veshje me llustër, kompatibël me llustrën e faqes së derës. Jepini dorën e fundit llustrëve që mund të jenë gërvishur ose prishur ose kur vrimat e vidave janë mbushur, sipas instruksioneve të prodhuesit të dyerve. Përputhni ngjyrën dhe shkëlqimin e llustrës me atë të fabrikës duke përdorur materiale kompatibël për përdorim në vend. Llustra e shtresave plastike: E aplikuar që në fabrikë, e tipit të përgjithshëm ose për qëllim specifik, me trashësi minimale 1.25 mm. Ngjitni me tutkall shtresën plastike për dyert tambura, tek rimesoja e drurit, kompensata ose tek mbështetsja e pasme, për të formuar panelin e derës. Trashësia minimale e shtresës plastike dhe mbështetses sëbashku duhet të jetë 2.5 mm.

### 4. Veshje me Alukobond të kuq

Veshja e hyrjes se dhomes ku do te vendoset skaneri do te visht me alocobond ngjyre e kuqe, të cilat janë panelë të përbëra alumini për përdotim në ambjentë të jashtëme në fasada, pasi kanë

peshë e lehtë dhe është i lehtë për tu punuar, prerë dhe përkulur. Ky material siguron izolim të mirë dhe është i qëndrueshëm ndaj kushteve të motit, erozionit, ndotjes zjarrit dhe ujit

Paneli alucobond është i përbërë nga një bërthamë polietileni me trashësi 4 mm e veshur nga të dyja krahët me mbulesë alumini me trashësi 0.5 mm dhe e lyer me boja rrëshire PVdF ose ekuivalente.

Paneli alucobon duhet të përmbushë standartin BS EN ISO 11925-2: 2010 ose ekuivalent lidhur me reagimin ndaj zjarrit.

### **Punime Tarace**

1. Shtresë betoni M.100 (për pendencë)

Ky ze perfshin shtrimin me pendece (pjerresi) te taraces me shtrese betoni M.100.

2. Llustër çimento 2 cm

Shtresë mbrojtese Llaç çimento 1:2 mbi shtresën termoizoluese, me trashesi minimale prej 2 cm dhe me fuga çdo 2 m ne te dy drejtimet dhe 2 cm te gjera dhe të mbushura me perzierje rërë dhe bitumi, e niveluar mire dhe e ilustruar me pluhur çimentoje duke perfshire çdo punim tjetër per ta konsideruar Shtresën mbrojtese te perfunduar ne menyre perfekte. Sistemimi i oxhakut duke perfshire çdo detyrim dhe mjeshteri. Ne perfundim te procesit te hidroizolimit, te pastrohen mbeturinat si ne tarace ashtu dhe ne objekt.

3. H/Izolim 2 K.K + 3 duar me bitum

Hidroizolim Katrama cilesia I 4 mm me mbivendosje 10% dhe Katrama cilesia I 4.5 kg granil me mbivendosje 10% , te kryqezuara mbi siperfaqe te rrafshet, te pjerret ose vertikale, deri poshte kopertines, perfshire mbivendosjen e lidhjeve (minimumi prej 12 cm ), punet e perkohshme per te gjithë kohezgjatjen e punes, e përbërë nga strukture druri ose hekuri dhe siper saj me nje pelhure te papershkrueshme ose te ngjashme per mbrojtjen nga shiu, qe do te aplikohet ne siperfaqen mbi te cilen po punohet , si dhe heqjet, spostimet, mberthimet etj., si dhe çdo detyrim tjetër te nevojshem per ti dhene fund punes ne menyre perfekte. Riberje e nje Shtresë finale suvatimi mbi pjeset vertikale te guaines.

4. Kornizë me pllakë mermeri (parapeti)

Parapeti i taraces do te vishet me pllaka mermeri te cilesise se pare.

### **Punime Bojatisje**

1. Bojë Hidroplastike

Lyerja do te behet me bojë me aftesi të lartë mbulimi dhe qendrueshmerie ne larje, ekologjike dhe antimikrobikale, pa permbajtje amoniaku, pa erë për përdorim të brendshëm. Boja të jetë e tillë që të parandalojë rritjen e mikrobeve, duke qënë e përshtatshme për përdorim në ambiente spitalore. Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të mbushjes dhe stukimi i

riparimeve. Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Pasi të stukohen sipërfaqet përpara lyerjes do të trajtohen me primer. Prajmeri është me përbërje silikoni akrilik, me bazë uji gjysëmtransparent dhe ekologjik. Është i përshtatshëm për përdorimi në ambiente të brendshme dhe të jashtëme, me veti hidroizoluese dhe nuk përmban amoniak apo substanca të tjera të rrezikshme, siç janë hidrokarburet aromatike, metale të rënda.

Boja përpara përdorimit duhet të hollohet me ujë deri në masën 10%. Ngjyrat do të përcaktohen nga autoriteti kontraktor. Të dhënat teknike të bojës:

Viskoziteti: 105 -110 ± 10 KU (ASTM D 562, 25° C) ose ekuivalent

Densiteti: 1,40 – 1,48 ± 0,02 Kg/L (ISO 2811) ose ekuivalent

Aftësia mbuluese: 11 - 13 m<sup>2</sup> /L

Boja duhet të përmbushë standartet:

Standartin “EU ECOLABEL” (Ekologjik) sipas Direktives Europiane 2014/312/EEC ose ekuivalent.

Standartin Antibakteriale sipas ISO 22196 ose ekuivalent.

### **Punime Hekur Betoni**

Punime hekuri per te gjithë elementet prej betoni te armuar qe prodhohen ne kantjer, me hekur me karakteristika celik C-3 me Ra=2100 kg/cm<sup>2</sup> , ne dimensione dhe forma sipas elementeve te projektuara ne fletet përkatëse te projektit dhe sipas te gjitha kushteve teknike ne fuqi si normativat e kthimit te ganxhave, te zgjatimeve per hekurit me permasa te gjate etj., per lende te pare (hekur) te shoqeruar me certifikatat e provave laboratorike per karakteristikat qe duhet te plotesoje, hekur pa perbajtje ndryshku duke perfshire çdo pune apo kerkese tjeter per ta konsideruar punimin e hekurit te perfunduar ne menyre perfekte.

### **Punime Prishje**

#### 1. Kruarje petkë qelqere

Ky ze perfshin punimet e kruarjes nga suvaja e mureve dhe tavanit te gelqeres se vjeter me shpatull.

#### 2. Prishje murr guri (hapje dere hyrje)

Përfshin prishjen e pjesshme të muraturave prej guri, pa përfshirë themelet. Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha masat e nevojshme për përforcimin dhe konsolidimin e murit përreth (nëse është e nevojshme).

#### 3. Prishje murr tulle (dyer të brendëshme)

Përfshin prishjen e plotë ose të pjesshme të muraturave prej tulle ose elementeve prej qeramike duke përfshirë pllakat dhe themelet. Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha masat e nevojshme për përforcimin dhe konsolidimin e ndërtesave përreth (nëse është e nevojshme)

#### 4. Prishje trotuari egzistues (Drenazhi)

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Ky ze perfshin prishjen e trotuarit ekzistues dhe drenazhit nen te.

### **Punime Drenazhi**

#### 1. Gërmim dheu kanal

Gërmim dheu themele ose per punime nentokesore, deri në thellesine 1,5 m nga rrafshi i tokes, ne truall te çfarëdo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rërë, zhavorr, gure etj..), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit te themeleve me materialin e Gërmimit te kryer me krah, si dhe spostimin brenda ambientit te kantierit.

#### 2. Veshje gurri me polisterol jeshil H = 2 m

Ky ze perfshin veshjen emurit te gurit nga jashte me polisterol jeshil deri ne lartesine 2 metra.

#### 3. Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit

Gërmim në një thellësi 15 cm nga niveli i tokës; vendosja e bordurave të parafabrikuara me beton M 200 me dimensione 25x12 cm me gjatësi të ndryshme sipas skicave përkatëse dhe me bazament të futur 15 cm në tokë; 15 cm është shtresë zhavor lumi pa mbeturina; 6 cm shtresë betoni M 100.1 me fugaturat në çdo 3 m të mbushura me zift dhe rërë niveluar dhe me pjerrësi sipas vizatimeve përkatëse e formuar me shtresa të vibruara mirë; pllakat e çimentos të vendosura me llaç gëlqere me dozaturën përkatëse për m<sup>2</sup>: 1.02 m<sup>3</sup> llaç gëlqere (tipi 15) 4 kg çimento ( tipi 400). ujë, ngjithës, pastrimi dhe plotësimi i gjithë kërkesave për një punë me cilësi të mirë.

### **Punime H / Sanitare**

#### 1. F.V. Tubo xingato Ø 1"

Ky ze perfshin instalimin ne sistemin e e furnizimit me uje te tualetit te tubave xingato Ø 1"

#### 2. F.V. Tubo të zeza shkarkimet

Ky ze perfshin instalimin ne sistemin e shkarkimit te tualetit te tuba PVC ngjyre e zeze.

#### 3. F.V. Wc allafrënga importi

Në ambientin e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve te tipit alla frenga. Ato janë me material porcelani dhe montohet sipas udhëzimeve të dhëna nga supervizori.

#### 4. F.V Lavaman porcelani importi me mishelator

Në ambientin e tualetit, gjithmonë duhet të parashikohen pajisjet hidrosanitare përkatëse (lavamanet) të cilat shërbejnë si vende për larjen e duarve dhe ftyrës së fëmijëve. Lavamanet mund të jenë metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose të montuar në

vepër. Lloji i materialit përbërës të tyre duhet të përcaktohet në projekt nga projektuesi. Lavamanët duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi. Lavamanet e porcelanit dhe mbështetësja e tyre fiksohen në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Pas fiksimit të saj në mur duhet të bëhet vendosja e rubinetave me tunxh të kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njëkohësisht lavamani duhet të pajiset edhe me pileten e tij metalike. Pileta duhet të vendoset në pjesën më të ulët të sipërfaqes së gropës mbledhëse ku është hapur një vrimë me përmasat e piletës. Lavamani ka një gropë mbledhëse me përmasa 40/60 x 36-45 cm në varësi të llojit dhe modelit të zgjedhur. Përmasat e lavamanit janë në varësi të llojit dhe modelit të tyre. Lavamanet vendosen në lartësi 75- 85 cm sipas kërkesës së projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes së tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide, WC, etj) duhet të jetë të paktën 30 cm. Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit të ujrave me anë të piletës, tubit në formë sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mësipërme mund të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Tubi i lidhjes duhet të jetë PVC me të njëjtat karakteristika teknike të tubave të shkarkimit të ujrave. Gjatësia e këtyre tubave është 20 - 40 cm. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të piletes ku janë vendosur. Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me uje me anë të dy tubave fleksibel me gjatësi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", të cilët bëjnë lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me ujë të ngruhtë dhe ujit të zakonshëm. Në vendin e lidhjes së rubinetit me lavamanin duhet të vendosen gomina të përshtatshme, për të mos bërë lejimin e rrjedhjes së ujrave. Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet të bëhen me tubat përkatës dhe me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Një model i lavamanit që do të përdoret sëbashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimi dhe të garancisë do të jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt.

### **Të Ndryshme**

#### 1. F.V Vetratë D/Plast DXH (Reklama dhe ndriçimi jashtë)

Janë reklama të thjeshta, të ndriçuaradhe me lidhje elektrike. Për montimin e reklamave do të veprohet njësoj si për montimin e tendave; do të vidhosen me trapano vidhat e fiksimit të konstruksionit metalik.

#### 2. Prishje konstruksioni metalik të ngrohjes

Çmontimi i konstruksionit të vjetër të ngrohjes dhe depozitimi i këtij konstruksioni në magazinat e autoritetit.

#### 3. Parmak Inoksi për personat me aftësi të kufizuar

Te shkallet do të instalohen patmake inoksi për personat me aftësi të kufizuara.

#### 4. Tub Inoksi për ajrim për gazrat e Rezonancës Magnetike

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Ne dhomen e rezonances magnetike do te instalohet tub inoxi per ajrimin e dhomes nga gazrat qe cliron aparatura e rezonances.

### 5. Ndriçues Plafonierë 60 x 60

Ne tavan do te instalohen plafoniere LED me permasa 60 x 60 cm.

## Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

PREVENTIVI - Punime të Ndërtimit

EMERTIMI I OBJEKTIT : "Rikonstruksion dhe përshtatje e ambientit ku do instalohet MRI"

Nr	Analizë	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia
		<b>Punime dheu</b>		
1	2.1	Gërmim dheu themel	m <sup>3</sup>	16
2	2.37/5a	Transport auto deri 5 km (Mbeturina + Dhera)	m <sup>3</sup>	76
3	AN	Transport me krahë 50 ml (Mbeturina + Dhera)	m <sup>3</sup>	76
		<b>Punime Muratori</b>		
4	2.52/1	Mur guri themel e xokul LL.B. M.15	m <sup>3</sup>	15.7
5	2.121/1	Brez B/A M.150 15cm mbi themel	m <sup>3</sup>	2.3
6	2.64/1	Mur tulle i plotë 25 cm LL.B. M.15	m <sup>3</sup>	20.1
7	2.64/1	Mur tulle i plotë 12 cm LL.B. M.15	m <sup>3</sup>	5.2
8	2.54/1	Zënie dritare egzistuese me mur guri	m <sup>3</sup>	2.4
		<b>Punime Betonil dhe B/Arme</b>		
9	2.119/1a	Arkitratë B/Arme M.200 Parafabrikat	m <sup>3</sup>	0.4
10	2.119/1	Trarë B/Arme M.200 Monolit	m <sup>3</sup>	0.8
11	2.158	Soletë B/Arme M.200 Monolit 15 cm	m <sup>3</sup>	6.15
12	2.200/1	Termoizolim solete me polisterol	m <sup>2</sup>	40
		<b>Punime Shtresash</b>		
13	2.262	Shtresë betoni M.100 (Shtresa)	m <sup>3</sup>	4.4
14	2.258	Shtresë zhavorri 10 cm	m <sup>3</sup>	3.2
15	2.195	Izolim dysheme me bitum	m <sup>2</sup>	34
16	2.267/1	Shtresë dysheme me pllaka porcelanat C.I të bardha importi	m <sup>2</sup>	98
17	2.288	Trotuar komplet gjerësi 15 ml (i ri)	m <sup>2</sup>	21
		<b>Punime Suvatimi</b>		
18	2.310	Suva murr tulle i brendshëm LL.B. M.15	m <sup>2</sup>	111
19	AN	Fino mbi murret e brendshëm godina egzistuese	m <sup>2</sup>	246
20	2.326	Veshje me pllaka majolike në WC H = 2.5	m <sup>2</sup>	40
21	2.343	Suvatim i jashtëm Granil + Çimento e bardhë	m <sup>2</sup>	33
		<b>Punime Dyer - Dritare</b>		
22	2.375/1	F.V Dritare D/Plast + D/Xham	m <sup>2</sup>	14.1
23	2.383/2	F.V Dyer të brendëshme druri	m <sup>2</sup>	19.1
24	2.383/2	F.V Derë e jashtme druri (Hyrja)	m <sup>2</sup>	8.2

## Dokumenta Standarde të Tenderit

25	AN	Veshje me Alukobond të kuq	m <sup>2</sup>	19
<b>Punime Tarace</b>				
26	2.262	Shtresë betoni M.100 (për pendencë)	m <sup>3</sup>	3.2
27	2.264	Llustër çimento 2 cm	m <sup>2</sup>	45
28	2.197	H/Izolim 2 K.K + 3 duar me bitum	m <sup>2</sup>	45
29	2.355/a	Kornizë me pllakë mermeri (parapeti)	m <sup>2</sup>	3.6
<b>Punime Bojatisje</b>				
31	2.404	Bojë Hidroplastike	m <sup>2</sup>	457
<b>Punime Hekur Betoni</b>				
32	2.166	F.V Hekur Betoni periodik $\pm\phi$ 10	ton	1
33	2.412	Parapet shkalle metalik	ton	0.12
<b>Punime Prishje</b>				
34	AN	Kruarje petkë qelqere	m <sup>2</sup>	246
35	2.426/a	Prishje murr guri (hapje dere hyrje)	m <sup>3</sup>	1.8
36	2.426	Prishje murr tulle (dyer të brendëshme)	m <sup>3</sup>	3.4
37	2.426/3	Prishje trotuari egzistues (Drenazhi)	m <sup>3</sup>	4.5
<b>Punime Drenazhi</b>				
38	2.15	Gërmim dheu kanal	m <sup>3</sup>	48
39	2.239/a	Veshje gurri me polisterol jeshil H = 2 m	m <sup>2</sup>	49
40	2.258	Mbushje me gurë + zhavor	m <sup>3</sup>	48
41	2.288	Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit	m <sup>2</sup>	49
42	2.29	Bordura trotuari 20 x 35 të parapërgatitura	ml	33
<b>Punime H / Sanitare</b>				
43	2.491	F.V. Tubo xingato $\phi$ 1"	kg	9.75
44	2.494	F.V. Tubo të zeza shkarkimet	kg	2.89
45	2.501	F.V. Wc allafrënga importi	copë	3
46	2.495	F.V Lavaman porcelani importi me mishelator	copë	3
<b>Të Ndryshme</b>				
47	2.373/1	F.V Vetratë D/Plast DXH (Reklama dhe ndriçimi jashtë)	m <sup>2</sup>	2.5
48	2.182/a	Prishje konstruksioni metalik të ngrohjes	ton	1
49	2.410/a	Parmak Inoksi për personat me aftësi të kufizuar	ml	3.1
50	2.410/b	Tub Inoksi për ajrmpër gazrat e Rezonancës Magnetike	ml	10
51	2.a-125	Ndriçuesa Plafonierë 60 x 60	copë	40



## Dokumenta Standarde të Tenderit

### PREVENTIVI - Punime të Imiantit të Ngrohje - Ftohjes

#### EMERTIMI I OBJEKTIT : "Rikonstruksion dhe përshtatje e ambientit ku do instalohet MRI"

Nr	Analizë	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia
<b>A - MAKINERI - PAISJE</b>				
1	AN	F.V Pajisje kondicionimi Set Inverter 18000 btu/h, ngarkesa ftohëse 5.2 kw, ngarkesa ngrohëse 6.0 kw, temperatura e punës - 20°C	copë	3
2	AN	F.V Pajisje kondicionimi Set Inverter Kanalor 18000 btu/h, ngarkesa ftohëse 5.2 kw, ngarkesa ngrohëse 6.4 kw, temperatura e punës - 20°C	copë	1
3	AN	Radiator Panel 22/600/800	copë	1
4	AN	Radiator Panel 22/600/1000	copë	2
5	AN	Kollonë radiatorit me kokë termostatike	copë	3
6	AN	Grillë shiu me fletë menteshe 20 x 30 cm	copë	1
7	AN	F.V Damper - Serolotur Analog - Potenciometër Analog - Transformator 230/24 V	copë	1
<b>B - ARMATURA - APARATURA</b>				
1	AN	F.V Valvul me sferë 1 ½"	copë	3
2	AN	F.V Valvul me sferë 1"	copë	2
3	AN	F.V Valvul me sferë ½"	copë	3
4	AN	F.V Filtër uji 1½	copë	1
5	AN	F.V Hollandezi 1½	copë	2
6	AN	F.B XHunto Antivibruese	copë	2
7	AN	F.V I Plotësimi të ujit (Grupit të mbushjes)	copë	1
8	AN	F.V I Kundravalvulës ½	copë	1
9	AN	F.V I Termomanometrave	copë	2
<b>C - PUNIME INSTALIMI</b>				
1	AN	F.V Kanale ajri prej llamarine	kg	150
2	AN	F.V Armofleks me ngjitje për izolimin e kanalit	m <sup>2</sup>	23
3	AN	F.V Aksesorë montimi për kondicionerët	komplet	1
4	2491	F.V Tuba xingato 1 ½"	kg	45.1
5	2492	F.V Tuba xingato 1"	kg	29.1
6	2492	F.V Tuba xingato ½"	kg	7.2
7	2494/a	F.V Tubo Cu e rakorderi Ø 15x1	ml	14
8	AN	F.V Armofleks 1½ (54x13) mm	ml	10
9	2535/c	F.V Armofleks 1" (35x9) mm	ml	10

## Dokumenta Standarde të Tenderit

### PREVENTIVI TOTAL - Punime të Rrjetit Elektrik dhe Fuqisë

#### EMERTIMI I OBJEKTIT : "Rikonstruksion dhe përshtatje e ambientit ku do instalohet MRI

<b>I. Kabina Elektrike</b>				
Nr	Analizë	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
<b>A - Montim Kabine</b>				
1	20000597	Celës T.M,6-25 kV,400A,16kA,i brendshëm	cope	1
2	20001984	Set Siguresse 10 kV 10A	cope	3
3	20001509	Automate, 4x250 A/0.4 kV	cope	2
4	20000984	Vaj Trasformator 25kV	liter	215
<b>B - Punime teknologjike, montimi dhe transport</b>				
1	2.a-98	F.V.Hekur shirit i galvanizuar Fe-Zn 40x4mm	m	39
2	2.a-96	F.V- percjellesit te tokezimit çelik i galvanizuar Ø12	m	20
3	MK -70	F.V.Kapikorde per percjelles Fe/Zn Ø 12mm	cope	14
4	2.a-73	F.V .Elektrode tokezimi "+St/Zn 50x50x5,L=1,5 m	cope	4
5	L6-197	F.V.Percjelles i rrumbullaket Fe/Zn Ø 16mm	ml	10
6	L6-161	Montim Transformator Fuqie 10/0.4 Kv,180kva	cope	1
7	L6 - 87 an	F.V. Terminal per kabell TM,XLPE Al , 1x240 mm <sup>2</sup>	cope	6
8	L6 - 74/c	F.V. Kabell TU, me izolacion XLPE Al , 4x95 mm <sup>2</sup>	m	20
9	L6 - 108	F.V. Kapikorda sy- qaf gjate CU /AL, S=240 mm <sup>2</sup>	cope	8
10	L6-37	Montim siguresse TM	cope	3
11	L6 - 120	Montim thike ngarkese TM 10 kV	cope	3
14	L6 - 364	Kolaudimi i transformatoreve te fuqise	cope	1
15	L6 - 401	Kolaudimi i rezistences se tokezimit	cope	1

<b>II. Ndërtim i rrjetit shpërndarës Rep.Rezonancës</b>				
Nr	Analizë	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
<b>A - Makineri dhe pajisje</b>				
1	4.151/a62	F.V. Kabell 5x4 mm	ml	230
2	4:1517/6.41	F.V.Kabell 3x1.5 mm	ml	140
3	2.485/b	F.V.Priza 1 fazore	cope	30
4	2.485/2	F.V.Çeles ndriçimi	cope	12
5		F.V.Ndriçusa luminishente2x36W-IP65	cope	16
6	an.E-1-3.12	F.V.Kanelina plastike 90x60	ml	70
7		F.V.Kabell 4x25	ml	30

## Dokumenta Standarde të Tenderit

8		F.V.Tub plastik Ø12	ml	60
9		F.V.Kapse,bryla plastike	cope	150
10		F.V.Kabell 4x1x90	ml	30
11		F.V.Kabell 4x1x70	ml	15

### III. Ndërtim i rrjeti TU Kabllor Rep.Rezonancës

Nr	Analizë	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
<b>A - Makineri dhe pajisje</b>				
1		Percjelles Cu-XLPE 1x160 mm <sup>2</sup>	ml	120
2		Kapikorda Cu Ø 240	cope	25
<b>B - Punime teknologjike, montimi dhe transporti</b>				
1		Shtrim kablli ne kanaline Kab-Rep Rezonances	ml	120
2		Kryerje koke kablli TU	cope	10

### IV. Ndërtim i Tokëzimit të Kafazit Rep.Rezonancës

Nr	Analizë	Emertimi i punimeve	Njesia	Sasia
<b>A - Punime teknologjike, montimi dhe transport</b>				
1	2.a-98	F.V.Hekur shirit i galvanizuar Fe-Zn 40x4mm	m	40
2	2.a-96	F.V- percjellesit te tokezimit çelik i galvanizuar Ø12	m	22
3	MK-70	F.V.Kapikorde per percjelles Fe/Zn Ø 12mm	cope	20
4	2.a-73	F.V .Elektrode tokezimi "+St/Zn 50x50x5,L=1,5 m	cope	12
5		F.V. Morseta St/Zn per tokezimin	cope	6
6		F.V.Percjelles i veshur PVC - Cu 1x35mm <sup>2</sup>	ml	36
7	L6-401	Kolaudimi i rezistences se tokezimit	cope	1

## GRAFIKU I PUNIMEVE

Për vetë specifikën e objektit, punimet do të ndjekin një rend të tillë që fillimisht të përgatitin kushtet për futjen dhe instalimin e makinerisë MRI, dhe pas tyre kryen punimet e tjera paralelisht me punimet speciale të montimit të pajisjes.

Këto punime konsistojnë në hapjen e murreve, punimet e shtresave në sallën e makinerisë, dhomën teknike, dhomën e komandës, atë të instalimit të UPS, hollit hyrës, punimet e rrjetit elektrik dhe fuqisë, si dhe punimet e kondicionimit, dhe pas futjes së pajisjes në sallë, paralelisht me punimet e instalimit të saj, vazhdohet me punimet e tjera, rifinitura, shtresa, lysterje, dyer dritare apo punimet e jashtme. lysterje, dyer dritare apo punimet e jashtme.

Grafiku i përafërt i punimeve është ky që po prezantojmë në këtë përshkrim të shkurtër, kurse në momentin e lidhje së kontratës do të jetë i specifikuar.

**Shtojca 14.**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_





## Shtojca 17

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon për objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsuara. Veprimet e korrupsuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë

zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen

dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezykshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

#### **Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

#### **Neni 18: Disponimi i Kantierit**

